



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:036776

Datë: 13.11.2020

Numri i dokumentit: 01268666

**P.nr.5345/18**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtari Avni Sylja, me Bashkëpunëtoren Profesionale Bleta Gashi Rrusta në çështjen penale kundër të akuzuarit L. H., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.5324/18, të datës 14.12.2018, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor: dënim me gjobë, me datë 13.11.2020, mori:

### A K T G J Y K I M

**Pranohet** Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.5324/18, të datës 14.12.2018, gjykata jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### I akuzuari:

**L. H.**, i biri i B. dhe nënës Sh. e gjinisë P., I lindur më datë ..... në Gj., me vendbanim në rrugën e ‘.....’, me nr. Personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### ËSHTË FAJTOR

#### Për shkak se:

Me datë 08.08.2018, rreth orës 17:00 në rrugën ‘Luan Haradinaj’ në Prishtinë, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike ashtu që pasi zyrtarët policor kishin ndaluar të pandehurin te Pallati I Rinisë, gjatë kontrollimit nga njësia policore në trupin e tij I ka gjetur një çese të mbushur me narkotike, e llojit heroinë me peshë të përgjithshme 2.09 gram.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata komfor neneve 7, 17, 21, 41, 43, 46 të KPRK, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së:

### G J Y K O N

Të akuzuarin **L. H.** me dënim me gjobë në shumë prej **150.00€ (njëqind euro)**, të cilin dënim obligohet të paguaj duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 46 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burgim, ku një ditë burgimi do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Obligohet i akuzuari që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20€, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 275 par 3 të KPRK-së, substanca psikotropike-narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 2.09 gram konfiskohet.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.5324/18, të datës 14.12.2018, ka akuzuar L. H., se ka kryer veprën penale - Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, komfor nenit 493 të KPPK, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, e posaçërisht vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve i datës 08.08.2018, tregojnë qartë se tek i pandehuri është gjendur substancë me përmbajtje marihuana me peshë 2.09 gram, si dhe foto dokumentacioni në shkresat lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike e llojit heroine me peshë prej 2.09 gram në bazë të nenit 275 par 3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor u mor komform nenit 450 të KPPK.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.2002/19 të datës 13.11.2020**

**Gjyqtari**  
**Avni Syla**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi – urdhri ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.